



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/19) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtrues i njohur nga, në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020 morri

VENDIM

Denoncimi dorëzuar nga parashtrues i njohur nga, deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të së cilës është formuar lënda me numër 12-749/1 me datë 31.01.2020, **RREFUZOHET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit pas rishikimit në përmbajtjen e denoncimit vërtetoi se nuk ka elemente për veprim kompetent, si dhe vepruan dhe veprojnë organet tjera kompetente.

Lënda me numër 12-749/1 me datë 31.01.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi nga KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e vendimmarrjes

Sqarim

Lënda me numër 12-749/1 me datë 31.01.2020 është formuar mbi bazë të denoncimit të marrur nga parashtrues i njohur nga

Në bashkangjitje të denoncimit është dorëzuar edhe denoncim penal deri tek Prokuroria Themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit me datë 27.11.2014. Denoncim penal parashtrohet kundër:

- nga përshkak të:
 - Moszbatim të vendimit të plotfuqishëm gjyqësorë nr. Po 11/90 dhe mosparaqitje të punëtorit në punë në përputhje me të njëjtë
 - Dyshime për keqpërdorim të detyrës zyrtare si U.D. Drejtor i "....." SHPK përshkak përvetësimit të mjeteve të huaja finansire si të ardhura personale në favor të vetin.
 - Mshetje të dokumentacionit për pengim të ngritje së kërkesës për realizim të plotfuqishëm të vendimit të gjyqit për kthim në vendin e punës
- nga (i emëruar për drejtor në vend të personit t.1) përshkak:
 - Moszbatim të vendimit të gjyqit dhe moslejim të qasjes deri tek hapsirat e punës
 - Mosnënshkrim të vendimit të përjashtimit ashtu që parashtruesi nuk mund të krijon marrëdhënje të reja pune dhe nuk mund të realizon të drejtën e sigurimit social dhe shëndetësor, si dhe të drejtën për pensionin minimal
- Gjykatësi pran Gjykatës Themelore përshkak të udhëheqjes jo të rregullt të lëndë P nr 191/98 dhe atë:

- Mossigurim të prezencës së të akuzuarit ose përfaqësues të tij;
- Mossigurim të ekspertizës pa pengesë nëpërmjet detyrës zyrtare;
- Mossigurim të dokumenteve për realizim të ekspertizës nga person i ndjerë
- 4. Inspektori për krim ekonomik përshkak:
 - Bisedë lidhje me denoncimin penal me datë 17.03.1999 e vulosur me numër 25.04.2000, në të cilën i thirrur ka qenë edhe, mirëpo nuk prezantoi në bisedë dhe inspektori nuk siguroi prezencë të tij.
 - PTHP në bazë të raportit të morri vendim KO nr. 85/2000 me datë 28.11.2000, se kinse nuk ekzistojnë dyshime për kryerje të veprave penale dhe denoncimi rrefuzohet si i pa bazë

Parashtruesi thekson se pas kalimit nëpër të gjitha instancat gjyqsore në vendin tonë, u drejtua edhe deri tek Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në Starzbur nëpërmjet avokatit nga Lënda është vulosur me numrë 20999/06, kundër IRJM me datë 09.06.2006 prej ku është marrë lajmërim se duhet të informohet gjykata dhe më tej të dorëzohen të gjitha vendimet relevante gjyqsore të vendit, me çka tek parashtruesi nxitë dyshim për veprimin e avokatit.

Gjithashtu, theksot se ka filluar edhe procedura e falimentimit St. Nr. 26/02 mbi ”.....” SHPK- debitori. Në përputhje me akuzat në denoncim, administruesi i falimentimit rrefuzoi të dëshmon në favor të parashtruesit dhe nuk e paraqiti të merr pjesë në Seancën përfundimtrare të kreditorëve të mbajtur me datë 24.06.2006.

Pas risikimit dhe hulumtimit të akuzave në denoncim, në mbledhje të Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit konstatoi se në lidhje me akuzat në denoncim janë hftytëzuar mjetet juridike para instatcave gjyqsore në Republikën e Maqedonis, si dhe para gjykatës ndërkombëtare, si dhe veprimi për denoncimin e lëndët penale është në komeptencë të prokurorisë. Në bazë të kësaj gjendje faktike, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vlerëson se nuk ka elemente për veprim kompetent për lëndën në përputhje me nenin 17 të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, gjegjësisht vepruan dhe veprojnë organe tjera kompetente.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë zë nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 12/19), vendosi në dispozitë të këtij vendimi.

Pas mbledhjes së senacës së KSHPK
Punoi: m-r B.K.Sh., këshilltarë
Miratoi: m-r V.G., anëtarë i KSHPK

**KOMISIONI SHTEETËROOR PËR
PARANDALIM TË
KORRUPSIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**